

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

02.02.2021

Ora17:23

**RENDI I DITËS**

**Projektudhëzimin "Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit."**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Ilirjan**            **CELIBASHI**            **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi**            **KQZ**            **Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, E.Meta**
- **Parti**            **Politike**            **PD (I.Kaso, L.Nuraj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:**

**Z.I.Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me "Caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit". Fjala është për ju zoti sekretar për të relatuar projekt-aktin.

**Z.Y.Merkaj:** Neni 92 pika 4 e Kodit Zgjedhorë përcakton se KQZ-ve jo më vonë se 6 muaj para datës së zgjedhjeve cakton një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen nga ana e subjekteve zgjedhore të detyrimit që lidhen me financimin e fushatës dhe detyrime të tjera të parshikuara në këtë ligj. Objekti i këtij projekt-udhëzimi është përcaktimi i kritereve të përzgjedhjes, procedurës dhe emërimin e monitoruesve ku objekt monitorimi, periudhën e monitorimit caktimin e subjektit të monitorimit si dhe raportimin e monitorimit në mënyrë të pavarur të paanëshme, transparente dhe jo diskriminuese. Projektudhëzimi cakton qartë

*Zbardhi materialin e incizuar  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

objektin e monitorimit, perjudhën e monitorimit, emërimin, modalitetet, mënyrën e paraqitjes së raporteve si dhe afatin e depozitimit të këtyre raporteve. Projektudhëzimi cakton kriteret mënyrën e aplikimit të kandidatëve për monitorues, dokumentacionin që duhet të paraqesin ata. Në këtë projektudhëzim është përcaktuar një dispozitë trazistore edhe mënyra e përzgjedhjes së monitoruesve për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2021. Projektudhëzimi përbën një përgjithësi përgarantimin e një procesi zgjedhorë të drejtë i cili synon ndarjen e qartë nëpërmjet ushtrimit të detyrave të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore dhe partive politike si në fushatën zgjedhore dhe ashtu një perjudhë 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Abuzimet nga burimet shtetërore apo publike është e vështirë të adresohet vetëm nëpërmjet nxjerrjes së akteve ligjore dhe angazhimi i kësaj kategorie përbën një garanci të shtuar për realizimin e qëllimit madhorë dhe përdorimin efektiv të burimeve shtetërore dhe publike nga partitë politike, bashkëlidhur për shqyrtim dhe miratim keni projektudhëzimin e mësipërm faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit zoti sekretar, përfaqësues të partive politike në lidhje me projektaktin në diskutim dhe parim?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partise Demokratike:** Po i nderuar jemi dakord parimisht me projekt-aktin që zëvendëson një udhëzim të ngjashëm të vitit 2017 lidhur me procesin e monitorimit. Shoh qe pak a shumë në përmbajtje rregullon të njejtat momente dhe të njejtat procedura, zgjidh dy, tre probleme praktike që janë vërejtur nga procesi i monitorimit të zgjedhjeve të vitit 2017, pra ka disa përmirsime, të cilat zgjidhin dy tre gjëra që në praktikë janë vërejtur që mund të ishin objekt kanfuzioni të punës tyre dhe më pas mbivendosim me detyrën që kanë

*Zbardhi materialin e incizuar  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

audituesit dhe që nuk kanë qenë strikt job discription i monitoruesve, kështu që parimisht jemi dakort. Vetëm një saktësim që e shohte te neni 6 përshembull kur bëhet thirrje për se udhëzimi ka karakter të përgjithshëm dhe synoj të aplikohet jo vetëm për këto zgjedhje por duke patur parasysh momentin kohorë në të cilin ne miratojmë të saktësohet që përjashtimisht për këto zgjedhje është e vetëkuptueshme që thirrja nuk mund të bëhet 1 vit përpara.

**Z.Y.Merkaj:** Është te neni 10.

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partise Demokratike:** Ndoshta se kam kapur te neni 10, po është për përjashtimin është e qartë. Pavarësisht se kjo pjesa do të vlejë dhe për zgjedhjet e ardhëshme shpresoj që udhëzimi të mos ketë më nevojë të ndërhyj por parimisht jemi dakort domethënë se na zgjidh dhe disa problematika që na u krijuan në 2017.

**Z.I.Celibashi:** Po, faleminderit zoti Kaso! Diskutim tjetër me përfaqësuesit e tjerë të partive politke, nuk ka? Atëherë kalojmë në shqyrtimin nën për nën të këtij projektakti. Neni 1, Objekti. Dakord! Neni 2. Qellimi i monitorimit. Dakord! Neni 3. Periudha e monitorimit dhe emërimit të monitoruesve. Dakord! Neni 4. Objekti i monitorimit dhe emërimit të monitoruesve. Dakord! Neni 5. Modalitetet e monitorimit dhe mënyra e raportimit. Dakord! Neni 6. Kriteret dhe mënyra e aplikimit. Dakord! Neni 7. Verifikimi paraprak dhe procedurat e çertifikimit si monitorues. Dakord! Neni 8. Procedurat e caktimit. Dakord! Neni 9. Informimi i publikut. Dakord! Neni 10. Monitoruesit e zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 prill 2021. Pra kjo është dhe dispozita që është tranzitore dhe është posaçërisht e lidhur me monitorimin e zgjedhjeve të 25 prillit 2021. Pasi sikurse e thamë edhe në

*Zbardhi materialin e incizuar  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

relatime dhe ju e evidentuat, ky është një akt me karakter të përgjithshëm për të gjitha llojet e zgjedhjeve që mund të zhvillohen në Shqipëri. Dakord dhe me nenin 10. Neni 11. Dispozitat tranzitore po prap për zgjedhje të përgjithshme për vitin 2021. Neni 12. Shfuqizime. Në këtë akt shfuqizohet udhëzimi nr.2, datë 01.06.2017, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për miratimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjidhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore. Mirë, ky akt hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Atëherë mbyllet dhe shyrtimi i kësaj pike të rendit të ditës.

**Udhëzimi nr.1**

*Zbardhi materialin e incizuar  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

02.02.2021

Ora 17:19

**RENDI I DITËS**

*Projektudhëzim “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”;*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ** Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, E.Meta
- **Parti Politike** PD (I.Kaso, L.Nuraj), PDIU (Sh.Sulo)
- **Vëzhgues:**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me projekt udhëzimin që ka të bëjë me procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave dhe subjektet zgjedhore. Atëherë z.sekretar, fjala është për ju!

**Z.Y.Merkaj:** Ky projekt udhëzim vjen në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, si dhe reflektim të plotë të rolit dhe rëndësisë së vëzhguesve zgjedhorë, në çdo fazë të procesit dhe në çdo komision zgjedhor dhe vend numërimit të votave ku ata akreditohen. Përcaktimi i procedurave të akreditimit, të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve si dhe rregullat tërësore të vëzhgimit të zgjedhësve,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

mundësojnë përmbushjen me profesionalizëm të detyrës nga ana e tyre. Projekt udhëzimi ka në përmbajtjen e tij 5 krerë dhe përbëhet nga 6 grup nene. Kreu i parë përcakton qëllimin e këtij projekt udhëzimi, kushtet për tu zgjedhur si vëzhgues dhe kohë zgjatjen e mandatit të tyre të ndarë në vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër. Kreu i dytë përcakton procedurën e zgjedhjes së vëzhguesve si dhe kërkesat për akreditim të OJF-ve dhe organizatave të huaja, organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësuesëve të shteteve të huaja. Projekt udhëzimi përcakton dhe kërkesën se kërkesa për akreditimin e OJF-ve, organizatave shqiptare dhe të huaja paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ku merret dhe akreditimi, ndërsa për subjektet zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i delegon kompetencën KZAZ-së, përkatëse. Kreu i tretë përcakton mënyrën e identifikimit të vëzhguesve pranë KZAZ-ve, KQV-ve dhe VNV-ve dhe pajisjet e tyre me autorizimin përkatës. Kreu i katërt përcakton të drejtat dhe detyrimet, detyrat shtesë për vëzhguesit krahas atyre të përcaktuar në nenin 7, pragrafi një dhe dy i Kodit Zgjedhor. Kreu i pestë parashikon shfuqizimin e akteve të mëparshme. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projekt udhëzimin e mësipërm. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit z.sekretar! Përfaqësues të partive politike, në lidhje me këtë projekt akt, në diskutim, në parim?

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Faleminderit i Nderuar! Nuk kemi kundërshtim në lidhje me projekt aktin, besoj që nuk ka ndryshime thelbësore në raport me aktet nënligjore që kanë rregulluar këtë proces më përpara, siç është edhe udhëzimi që shfuqizohet. Ka vetëm disa përmirësime, mesa po shoh. Kështu që, parimisht shprehemi dakord.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

**Z.I.Celibashi:** Po, faleminderit! Atëhere, qoftë edhe për procedurë formale, po kalojmë nen për nen në shqyrtimin e këtij projekt akti. Në lidhje me nenin 1, ka ndonjë propozim? Dakord. Për nenin 2, dakord. Neni 3, dakord. Nuk po i lexoj nenet, meqënëse jeni njohur të gjithë me materialin dhe me draftin dhe e keni gjithsesi përpara. Neni 4, dakord. Neni 5, dakord. Neni 6, dakord. Neni 7, dakord. Neni 8, dakord. Neni 9, dakord. Neni 10, dakord. Neni 11, dakord. Neni 12, dakord. Neni 13, të drejtat e vëzhguesve, dakord. Neni 14, detyrat e vëzhguesve, dakord. Neni 15 që ka të bëjë me shfuqizimet dhe Neni 16 që ka të bëjë me hyrjen në fuqi. Atëhere, meqënëse nuk kemi propozime për ndryshime të neneve, e miratoj aktin sipas draftit të propozuar. E mbyllim edhe këtë pikë të rendit të ditës!

**Udhezimi nr.2**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Seancë publike e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.  
Dt.02.02.2021*

02.02.2021

Ora 17:10

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Illirjan**            **CELIBASHI**            **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi**                **KQZ**                        **Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, E.Meta**
- **Parti**                **Politike**                    **PD (I.Kaso, L.Nuraj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Përfaqësuese të Organizatave:**            **Znj. Iris Luarasi**

**Z.I.Celibashi:**Atëhere, në seancën e sotme publike të zhvilluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kemi në rend dite shqyrtimin e këtyre projektakteve: “Projektudhëzimi për procedurat, e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat jo qeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të shteteteve të huaja si dhe mediat dhe subjekteve zgjedhorë”. Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me : “Projektudhëzim për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën e emërimit dhe objektin e monitorimit”. Pika e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me projektvendimin: “Për shperndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021”. Pika e katërt ka të bëjë me projektvendimin: “Për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Seancë publike e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.  
Dt.02.02.2021*

seksuale”. Pika e pestë e rendit të ditës ka bërë me projektvendimin: “Për emërimin e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të KZAZ-ve”. Gjithashtu, do të shtojmë edhe një pikë tjetër në rendin e ditës që ka të bëjë me projektvendimin: “Për lirin dhe emërimin dhe anëtarit të KZAZ-së nr.75 Qarku Korçë dhe të sekretarit të KZAZ-së nr.88 Qarku Vlorë”. Atëhere fillojmë me pikat e rendit të ditës, do të propozoj që fillimisht të shqyrtojmë projektvendimin që ka të bëjë me rregjistrimin e nismës ligjvënësë të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë për krijimin e regjistrimit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale, dhe pastaj vazhdojmë me çështjet e tjera të rendit të ditës të cilat kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me procesin zgjedhor. I japim fjalën sekretarit të KQZ-së për të relatuar në lidhje me këtë pikë, pastaj përfaqësuesit të organizatës që prezanton nismën.

**Z.Y.Merkaj:** Atëhere, në datë 09.06.2020, komiteti përfaqësues i nismës ligjvënësë znj. Iris Luarasi përfaqësuese e Qendrës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, znj. Ines Leskaj përfaqësuese e shoqatës “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” si dhe znj. Mirela Arqimandriti përfaqësuese e Qendrës “Aleanca Gjimore për Zhvillim” kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për të pajisur me fletën tip për mbledhjen e nënshkrimeve për propozimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 13, datë 30.06.2020 ka vendosur miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve. Në datën 20.10.2020 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa për shtyrjen e afatit të përcaktuar për mbledhjen e nënshkrimeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me datë 03.11.2020 ka vendosur të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve dhe më datë 29.12.2020, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë protokolluar

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Seancë publike e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.  
Dt.02.02.2021*

nënshkrimet e nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjore. Në mbështetje të sa më sipër, administrata ka bërë verifikimin e numrit të nënshkrimeve si dhe saktësinë e të dhënave të dokumentit të identifikimit të mbështetësve, brenda afatit të përcaktuar në ligj. Në total janë depozituar 960 fletë, nga ku rezulton se 22 428 nënshkrime janë të rregullta dhe 1 572 nënshkrime nuk janë të rregullta. Administrata e KQZ-së ke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëseve të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse. Nga procesi i verifikimit rezulton se janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në ligj. Në këto kushte në bazë të nenit 4, pika 2 të ligjit “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhesve në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet që nisma ligjvënëse të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës. Ka rezultuar se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën e plotëson numrin prej 20 000 zgjedhës. Administrata e KQZ-së vlerëson se nënshkrimet e depozituara nga përfaqësuesit e nismës për propozimin e projektligjit janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj dhe si të tilla duhet të pranohen. Për sa më sipër, në bazë të nenit 19 të ligjit për “Kodin Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i paraqitet për shqyrtim raporti dhe projektvendimi për shqyrtim dhe miratim e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve! Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Po, faleminderit zoti sekretar! Atëhere, i japim fjalën përfaqësuesve të organizatave, të cilat kanë prezantuar dhe prezantojnë këtë nisëm. Po zonja Iris Luarasi!

**Znj.I.Luarasi:** Faleminderit! Vetëm një përmbledhje e shkurtër e asaj që parashikon projektligji sepse në Shqipëri mungonte një “Rregjistër Kombëtar për

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Seancë publike e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.  
Dt.02.02.2021*

Autorët e Krimeve Seksuale”, ne u nisëm pikërisht nga fakti që vetëm në qytetin e Tiranës janë 50 veta të dënuar për krimin e dhunës seksuale me të mitur. Pra, për arsye pedofilie dhe këta në fakt monitorohen vetëm nga dy persona, kështu që kjo na çoi tek ideja e krijimit të një regjistri që ne mendojmë të jetë një regjistër publik sigurisht i limituar dhe me sanksione për ata që e keqpërdorin regjistrin. Kështu që draftin e kemi gati, e kemi konsultuar me shumë organizata sepse projektligji nuk është ndërtuar vetëm nga tre organizatat që kanë sjellë nismën po nga 27 organizata të Shoqërisë Civile. Madje përpara dy ditësh kishim edhe një tavolinë të rrumbullakët me penalistë të Universitetit Luarasi, kemi edhe një tavolinë në fund të javës me Fakultetin Juridik në Universitetin e Tiranës, dhe pastaj jemi gati për ta çuar projektligjin në Parlamentin Shqiptar. Kështu që ju falenderoj pa fund për këtë dashamirësinë dhe për të krijuar brenda të gjitha afateve ligjore edhe shtyrjen e mbledhjes së firmave për shkak të situatës që jetojmë në Shqipëri dhe jo vetëm në Shqipëri në të gjithë globin për shkak të pandemisë. Kështu që iu jam shumë mirënjohëse për gjithë procesin edhe për dashamirësinë që keni treguar! Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Po, faleminderit! Nga përfaqësuesit e partive politike ka diçka për të shtuar në lidhje edhe pse nuk ka të bëjë me procesin zgjedhor po ndoshta ndonjë fjalë mund të thuhet. Faleminderit!

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Faleminderit zoti Kryetar! Pavarësisht se ne si parti politike nuk shohim me vend të ndërhyrje në lloje të tilla vendimmarrjesh, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që për shkak të natyrës të tyre janë strikt të diskrecionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sigurisht duke aplikuar kriteret

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Seancë publike e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.  
Dt.02.02.2021*

ligjore, gjejmë rastin të përshëndesim si qytetar të angazhuar të këtij vendi nismën që vjen nga organizatat e shoqërisë civile. Vërtet është koha për të bërë një hap përpara në këtë drejtim dhe le të shpresojmë që kjo iniciativë të jetë fillimi i një procesi ndërgjegjësimit që pse jo të konkludojë edhe me vendimmarrjen përkatëse ligjore për të ofruar mekanizma të tillë edhe në Shqipëri si në mbarë botën e qytetëruar. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Atëhere, bazuar në nenin 19 pika 2, të “Kodi Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, dhe në nenin 14 paragrafi 1, shkronja a të ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 53 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” vendosa: Të regjistroj nismën ligjvënëse “Për krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale” propozuar nga Qendra “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” dhe Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të KQZ-së. Faleminderit!

**Vendimi nr.21**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*



2.02.2021

Ora 17:28

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për emerimin e kryetarëve dhe zv.kryetarëve të KZAZ-ve.”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, E.Meta**
- **Parti Politike PD (I.Kaso, L.Nuraj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:**

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me emërimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komisionit në zonat e administrimit zgjedhor.

Po zoti Sekretar, fjala për ju!

**Zoti Ylli Merkaj:** Sipas parashikimit të nenit 9, paragrafi 8 i rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve emëron kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-ve sipas propozimeve të KZAZ-ve. Komisionet e 92 zonave të administrimit zgjedhor kanë zhvilluar mbledhjen e parë në selitë përkatëse në datën dhe orën e përcaktuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në mbledhjen e parë komisionet kanë marrë vendim për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit. Vendimet e KZAZ-ve janë administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në analizë të përmbajtjes së vendimit të KZAZ-ve, për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit, rezulton

1

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 02.02.2021*

se vendimet janë marrë në përputhje me përcaktimet e paragrafëve 2, 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 9 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve. Në KZAZ-në me numër tek, ku anëtari i 7-të i përket Partisë Demokratike, kryetar është propozuar një prej anëtarëve të KZAZ-së, përfaqësues i Partisë Demokratike. Në KZAZ-në me numër çift, ku anëtari i shtatë i përket Partisë Socialiste, kryetar është propozuar njeri prej anëtarëve të KZAZ-së, përfaqësues i Partisë Socialiste. Në të gjitha KZAZ-të, zëvendëskryetari i propozuar, është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!


**Zoti Ilirjan Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike?! Po ...?!

Atëherë meqenëse nuk kemi propozime ose diskutime në lidhje me këtë projekt-akt, bazuar në nenin 19, paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, vendimi Nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, vendosa të emëroj kryetarët dhe zëvendëskryetarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij projekt-akti. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Atëherë, kemi përfunduar dhe me këtë pikë të rendit të ditës; kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës, ...

**Vendimi nr.22**

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

02.02.2021

Ora 17:36

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Lirimi dhe emërimi i anëtarit të KZAZ-së numër 75 Qarku Korçë dhe sekretarit të KZAZ-së numër 88 Qarku Vlorë”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Ilirjan**           **CELIBASHI**           **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi**           **KQZ**           **Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, E.Meta**
- **Parti**           **Politike**           **PD (I.Kaso, L.Nuraj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:**

**Z.I.Celibashi:** Kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës, që ka të bëjë me lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-së numër 75 Qarku Korçë dhe sekretarit të KZAZ-së numër 88 të qarkut Vlorë, po zoti sekretarë.

**Z.Y.Merkaj:** Partia Demokratike ka paraqitur në bazë të nenit 32 , paragrafi 2, shkronja d e Kodit Zgjedhor kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së numër 75 te Qarkut Korçë dhe Sekretarit të KZAZ-së 88 të Qarkut Vlorë. Propozimet e paraqitura plus dhe kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31 të Kodit Zgjedhor për kriterin e përcaktuar në nenin 31 shkronja ç janë kryer verifikimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ku ka rezultuar se nuk janë të dënuar me vendime penale të formës së prerë. Gjithashtu kandidatura e paraqitur për KZAZ-

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

në numër 88 ka arsim juridik. Bashkëlidhur po ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim vendimin e mëposhtëm, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit, nuk besoj se kemi ndonjë diskutim nga përfaqësuesit e partive politike. Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja ç dhe nenet 30, 31 dhe 32 paragrafi 2 shkronja d të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar vendosa të liroj nga detyra anëtarin e KZAZ-së numër 75 qarku Korçë zotin Mikail Nikolla Mejdi dhe të emëroj zotin Esmeraldo Xhevdet Kasolli. Të liroj nga detyra sekretarin e KZAZ-së numër 88 qarku Vlorë zotin Gelion Xhevahir Deti dhe të emëroj zotin Marin Panajot Suli. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe njoftohet KZAZ me numër 75 të Qarkut Korçë dhe KZAZ me numër 88 të Qarkut Vlorë. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve në internet, faleminderit. E mbyllim edhe këtë pikë të rendit të ditës njëkohësisht edhe seancën publike të ditës së sotme, faleminderit për pjesëmarrjen dhe diskutimet. Faleminderit edhe stafit të KQZ-së.

**Vendimi nr.23**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

02.02.2021

Ora 17:29

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shpërndarjen e fondeve vjetore të partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Illirjan            CELIBASHI            Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi                KQZ                                Y.Merkaj, E.Jorgaqi, M.Koja, E.Meta**
- **Parti                Politike                            PD (I.Kaso, L.Nuraj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:**

**Z.Illirjan Celibashi:** Kalojmë tek pika tjetër, që ka të bëjë me “Projektaktin për shpërndarjen e fondeve vjetore të partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021”. Fjala për ju, zoti sekretar, për ta relatuar projektaktin.

**Z. Ylli Merkaj:** Në zbatim të nenit 15, fraksion 2, pika 2, gërma “e” e ligjit “Për Partitë Politike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore. Ligji nr.137 , i 2020-ës, për buxhetin e vitit 2021, ka parashikuar fondin prej 140 milion lekësh si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2021. Neni 19, pika 2 e ligjit “Për Partitë Politike”, përcakton rregullat sipas të cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore të partive politike si më poshtë: 70% sipas numrit të deputetëve të

*Zbardhi materialin e incizuar  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare; në çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor, të parashikuar në Kodin Zgjedhor; 20% në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë fituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare; dhe pika c: 10% sipas përqindjes të fituar nëpërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare, dhe kanë fituar mbi 1% të votave në shkallë vendi. Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10 përqindëshi, i shtohet fondit prej 70%, që u ndahet partive parlamentare. Shuma totale që përfitohet nga secila parti politike si mbështetje financiare për vitin 2021 është shumatorja e të gjitha shumave që ...nga llogaritja e mësipërme. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, në datë 26.07.2017, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 qershor 2017. Shuma që përfiton secila parti sipas pikës dhe nenit 19, pika 2, gërma "a" e ligjit për partitë politike, përcaktohet në këtë mënyrë: Shuma prej 98 milionë lekë, e cila përbën 70% të shumës totale, do të shpërndahet, për të shpërndarë 140 milionë lekë i shtohet edhe shuma prej 345.800 lekë, e cila ngelet pa u shpërndarë nga 10 përqindëshi i shumës totale. Totali prej 98.345.800 lekë pjesëtohet me numrin e deputetëve të parlamentit shqiptar, 140, dhe rezultati prej 720 e 470 lekësh është shuma që përfiton partia për çdo deputet që ka në parlament. Për të gjetur shumën në lekë që përfiton çdo parti në bazë të nenin 19, pika 2, gërma "a" dhe ligjit "Për Partitë Politike" i ndryshuar. Shuma prej 7... shumëzohet me numrin e deputetëve për secilën parti, shuma që del për secilën parti përfundimisht është Partia Socialiste, e cila ka 48.34%, ka 6 milionë e ,,lekë, Partia Demokratike ka 28.85% , 4milionë e 39 mijë lekë, Lëvizja Socialiste për Integrim 14.28%, 1 milionë e ...lekë, Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet

*Zbardhi materialin e incizuar  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.02.02.2021*

4.81%, 673.400 lekë dhe Lista e Barabartë 1.25%, 175 mijë lekë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin e miratimit. Faleminderit!

**Z.Ilirjan Celibashi:** Po, faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me projektaktin? Nuk kemi? Atëherë, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja 1, shkronja “i” dhe paragrafin 2 të ligjit nr.10019, të datës 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, si dhe nenit 15/2, gërma”c” e nenit 19 dhe nenit 24 të ligjit 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike” i ndryshuar si dhe ligji 137/2020 “Për buxhetin” e vitit 2021, vendosa të shpërndaj fondin prej 140 milionë lekë partive polike për vitin 2021 sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi, dhe konkretisht për Partinë Socialiste, shuma është 63 milionë 417 mijë e 47 lekë. Partia Demokratike 38 milionë e 911 mijë e 877.

Lëvizja Socialiste për Integrim është 20 milionë e 12 mijë e 797.

Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet 7 milionë 447 mije e 477.

Lista e Barabartë 4 milionë e 841 mijë e 667 dhe Partia Social Demokrate: 5 milionë 369 mije e 137. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Atëherë kemi përfunduar edhe me këvendimi nr.të pikë të rendit të ditës.

**Vendimi nr.24**

*Zbardhi materialin e incizuar  
Lorena KONJA*